

Këshillit
12-09-25



Nr. 3102/ Prot

12-09-25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.814/1 prot.

Peshkopi, më 10.09.2025

Lënda: Për vendimin nr.53, datë 09.09.2025 të Këshillit të Bashkisë Mat.

BASHKISË MAT

KËSHILLIT BASHKIAK MAT

MAT

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Mat nr.53, datë 09.09.2025 “**Për miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028 për Bashkinë Mat**”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi, në zbatim të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Mat, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

P R E F E K T I


Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KESHILLI**



VENDIM

Nr. 53 datë 09.09.2025

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR SOCIAL 2026 – 2028 PËR BASHKINË MAT”

Në mbështetje të parashikimeve të **Ligjit nr. 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar), **Ligjit nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, **Ligjit nr. 57/2019** “Për asistencën sociale”, **Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030**, **Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026**, **Ligjit Nr. 18/2017** “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, **Ligjin nr. 163/2014** “Për urdhrin e punonjësit social”, **Ligjit nr. 9970/2008** “Për barazinë gjinore në shoqëri”, **Ligji, Nr.9355 datë 10.03.2005** “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”i ndryshuar, **Ligjin nr. 10221/2010** "Për mbrojtjen nga diskriminimi", **Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006** “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” **i ndryshuar**, **Ligjin Nr.9232, datë 13.05.2004** “Për programet sociale të strehimit”, **Ligji nr. 93/2014**, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”,si dhe në bazë të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Mat te miratoje si me poshte. Keshilli pas diskutimeve ne degjese publike te dates 03.09.2025 si dhe me komisonet perkatese,me 12 vota pro dhe 1 kunder;

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028 në Bashkinë Mat.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Prefektura.

KRYETAR

Altin BOJNI





Plani Vendor Social

Bashkia Mat
2026-2028



Falenderime

Bashkia Mat shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor Social 2026-2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Bashkisë Mat, i cili ka mbështetur këtë proces duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.



Tabela e përmbajtjes

Falenderime	2
1. Hyrje	6
2. Metodologjia.....	6
3. Legjislacioni	8
3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor	9
3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar	10
3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale	10
3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive	10
3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë	11
3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale.....	12
3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale	13
3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve.....	16
3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë.....	17
3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve	17
4. Analiza e të dhënave- vështirë i përgjithshëm.....	18
4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë.....	19
5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese	19
5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative	19
5.2 Individë përfitues sipas gjinisë	20
5.3 Individë përfitues sipas grupmoshës.....	21
5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike.....	21
5.5 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike.....	22
5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike	22
5.6.1 Familjet me të paktën një pjesëtar në moshë pensioni	23
5.6.2 Familjet me të paktën një anëtar PAK.....	23
5.6.3 Familjet Rome ose Egjiptiane	23
5.6.4 Familjet me deri në 2 fëmijë të mitur	23
5.6.5 Familjet ku kryefamiljare është një grua.....	24
6. Strehimi Social.....	24
6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social	24
6.2 Numri i familjeve përfituese për strehim social	25
6.3 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike	26
6.4 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare	27



6.5 Familje përfituese sipas programeve të strehimit	28
7. Punëkërkuesit e papunë në Bashkinë Mat	29
7.1 Të dhëna të përgjithshme:.....	29
7.2 Ndarja sipas njësive administrative:	29
7.3 Situata e Punëkërkuesve dhe Ndihmës Ekonomike.....	30
7.4 Trajnimet Profesionale.....	30
7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Mat.....	31
8. Personat me Aftësi të Kufizuara	32
8.1 Karakteristikat e Aftësive të Kufizuar	32
8.2 Shërbimi i strehimit social	33
8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës	33
8.5 Qendrat zhvilluese dhe rehabilituese sociale për individët me PAK	34
8.6 Shërbimi Shëndetësor	34
8.6 Treguesit Kryesorë të Shëndetit në Bashkinë Mat.....	35
9. Viktima të dhunës në familje	35
9.1 Mekanizmit Lokal për Dhunën në Familje	35
9.2 Dhuna në Familje sipas Njësive Administrative.....	36
9.3 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje.....	37
10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	38
10.1 Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve	38
10.2 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	39
10.3 Shërbimet për fëmijët në nevojë në Bashkinë Mat	41
10.3 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja)	42
10.4 Shërbimi i Arsimit Parashkollor	42
10.5 Shërbimi i arsimit parauniversitar	43
Në bashkinë Mat funksionojnë:.....	43
Frekuentimi në Arsimin Fillor	44
Frekuentimi në Arsimin 9-Vjeçar	44
10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkollë.....	44
10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	45
11.Familjet rome dhe egjiptiane	45
12.Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale.....	45
12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative.....	45
12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit	46



13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli	46
14. Migrantët dhe Emigrantët	47
15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Mat	47
16. Kapacitetet e bashkisë.....	48
17. Vizioni dhe Misioni	50
Vizioni.....	50
Misioni	50
18. Qëllimet dhe Objektivat.....	50
19. Plani i Veprimit	52
20. Monitorimi dhe raportimi	76
21. Bibliografi.....	78



1. Hyrje

Plani Social i Bashkisë Mat për periudhën 2026-2028 është një dokument strategjik që udhëheq vendimmarrjen në fushën e shërbimeve sociale në nivel vendor, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Shkurt-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Ky proces u mbështet nga ekspertë të fushës dhe u orientua nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për planifikimin social. Bashkia Mat ka ndërtuar një përvojë të vyer ndër vite në adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, duke konsoliduar shërbime dhe partneritete në nivel vendor dhe rajonal.

Plani synon të analizojë gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.

Përmes këtij Plani, Bashkia Mat synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë.

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Mat është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare. Më poshtë paraqiten hapat e ndjekur:

1. Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar

Fillimisht u realizua një shqyrtim i detajuar i dokumenteve ligjore dhe strategjike që udhëheqin planifikimin e politikave sociale në nivel kombëtar. Në fokus ishin:

- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël,
- Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor.

Kjo analizë shërbeu për të përcaktuar detyrimet dhe prioritetet që bashkia duhet të adresojë në nivel lokal.

2. Konsultimi me aktorë lokalë dhe ofrues shërbimesh

U zhvilluan takime konsultative me një gamë të gjerë aktorësh, për të siguruar që prioritetet e planit të reflektojnë realisht nevojat dhe perspektivat në terren. Këtu përfshihen:



- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe stafi teknik i bashkisë,
- Administratorë vendorë dhe përfaqësues të njësive administrative,
- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale,
- Partnerë të tjerë ndërinstitucionalë (arsimi, shëndetësia, policia, etj).

3. Analiza e të dhënave sociale dhe administrative

U mbledhën dhe u analizuan të dhëna të detajuara nga burime të ndryshme, përfshirë:

- Sistemi elektronik i shërbimeve sociale,
- Të dhëna administrative nga bashkia dhe njësitë administrative,
- Regjistrat e ndihmës ekonomike, PAK, pensioneve dhe shërbimeve ekzistuese,
- Statistikat e INSTAT dhe institucioneve kombëtare të monitorimit social.

Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e grupeve në nevojë, shportës së shërbimeve ekzistuese, dhe zonave me mungesa të theksuara në mbulim.

4. Vlerësimi i boshllëqeve në raport me standardet kombëtare

Bazuar në standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të miratuara nga Ministria përkatëse, u krye një vlerësim i kapaciteteve dhe mbulimit aktual në Bashkinë Mat. Ky vlerësim ndihmoi në:

- Identifikimin e boshllëqeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore,
- Përcaktimin e shërbimeve të reja të nevojshme,
- Prioritizimin e ndërhyrjeve për periudhën 2026-2028.

5. Hartimi i objektivave dhe Planit të Veprimit

Bazuar në të dhënat, konsultimet dhe boshllëqet e evidentuara, u formulua struktura logjike e Planit Social, përfshirë:

- Objektivat strategjike dhe specifike,
- Masat konkrete të ndërhyrjes,
- Treguesit e monitorimit,
- Aktorët përgjegjës dhe afatet për zbatim.

Mjetet e përdorura gjatë procesit:

- **Fokus-grupe** me komunitetin dhe përfaqësues të target-grupeve (PAK, të moshuar, gra kryefamiljare, të rinj).
- **Intervista gjysmë të strukturuar** me stafin e shërbimeve sociale dhe drejtues vendorë.
- **Pyetësorë të strukturuar** për mbledhjen e të dhënave nga njësitë administrative.
- **Analiza statistikore** e burimeve zyrtare për të ndërtuar një profil të saktë të nevojave sociale në territor.



Kjo metodologji e kombinuar ka garantuar një proces gjithëpërfshirës, të bazuar në evidenca dhe të përafruar me praktikatat më të mira të planifikimit social vendor.

3. Legjislacioni

Shqipëria ka zhvilluar kuadrin ligjor mbi mbrojtjen dhe përfshirjen sociale duke rregulluar kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, moshuarve, viktimave të dhunës në familje etj. Një rol të vecantë në ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale kanë edhe bashkitë.

Kjo rubrikë synon të paraqesë një përmbledhje të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshme të shërbimeve sociale që ofrohen në nivel vendor në Republikën e Shqipërisë. Ai shërben si një udhëzues praktik për bashkitë dhe institucionet e tjera të përfshira në projektimin, ofrimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të përmbushin nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë.

Standardet minimale përcaktojnë nivelin themelor të cilësisë, disponueshmërisë dhe aksesueshmërisë që një shërbim social duhet të përmbushë. Ato janë element thelbësor për sigurimin e një ofrimi të barabartë dhe të pandryshueshëm të shërbimeve në të gjitha bashkitë, mbështetjen e punës profesionale të strukturave vendore dhe ofruesve të tjerë të licencuar si dhe promovimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm në ofrimin e ndihmës sociale.

Dokumenti mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”;
- Ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”;
- Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktimat të dhunës, etj.;

- Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.



3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor

Garantimi i shërbimeve sociale në Shqipëri mbështetet në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në **Kreun V-Objektivat Socialë**, përmes **Neni 59**, shteti angazhohet të përmbushë detyrimet e tij ndaj qytetarëve në nevojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Këto objektiva përfshijnë promovimin e punësimit, sigurimin e të drejtës për strehim, aksesin në shërbime shëndetësore dhe arsim, përkujdesjen për të moshuarit, jetimët, invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës për shtresat më të cënueshme të shoqërisë. Ky kuadër normativ përbën themelin mbi të cilin ndërtohen politikat dhe programet për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e barabartë të qytetarëve në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Ligjet kryesore përfshijnë:

Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;	Ky ligj vendos bazat e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke theksuar rolin qendror të bashkive në planifikimin, sigurimin dhe financimin e këtyre shërbimeve, si dhe në monitorimin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve minimale.
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”	Sanksionon se bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për të ofruar dhe organizuar shërbime sociale për banorët e tyre. Neni 24 “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

	4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”	Regullon ndihmën ekonomike dhe përfshirjen e bashkive në procesin e identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të përfituesve të skemës së ndihmës.
Ligji nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”	Vendos rregulla për profesionin e punonjësit social, përfshirë kriteret e edukimit, etikës dhe licencimit. Ky ligj lidhet drejtpërdrejt me standardet për personelin që ofron shërbime sociale.

3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Shqipëria është palë nënshkruese dhe ratifikuese e disa konventave ndërkombëtare që ndikojnë drejtpërdrejt në politikëbërjen dhe standardizimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu Shqipëria është në process të përafrimit të legjislacionit me BE në kuadër të procesit të antarësimit. Këto instrumente ndërkombëtare janë reflektuar në legjislacionin kombëtar dhe përbëjnë bazën për monitorim ndërkombëtar dhe përgjegjshmëri në zbatimin e të drejtave sociale.

Në konventat kryesore të ratifikuara nga shteti shqiptar mund të listojmë:

- **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**

Kërkon ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror dhe vendos standarde për trajtimin e fëmijëve në institucionet sociale.

- **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)**

Neni 19 thekson të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet me mbështetjen e duhur.

3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale

3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe ndihmës sociale në territorin e tyre. Konkretisht, bashkitë janë përgjegjëse për:

- Identifikimin e nevojave sociale të komunitetit
- Planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të përshtatshme në nivel vendor
- Menaxhimin dhe financimin e shërbimeve
- Monitorimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare

Ky rol është i detyrueshëm dhe jo fakultativ, dhe është i lidhur ngushtë me mekanizmin e vlerësimit të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë



Neni 36 i Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; përcakton qartë përgjegjësitë e bashkive në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në territorin e tyre. Roli i bashkisë është shumëdimensional dhe fillon me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale, të cilat realizohen në bazë të hartës së vulnerabilitetit. Këto të dhëna përdoren më pas për të hartuar Planin Social Vendor, një dokument strategjik që përkthen nevojat në politika konkrete shërbimi.

Bashkia është përgjegjëse për programimin e buxhetit vendor dhe për përcaktimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore që duhet të ofrohen për komunitetin. Për realizimin e këtyre shërbimeve, ajo mund të kontraktojë ofrues të jashtëm përmes procedurave të prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bashkia ka detyrimin të bashkërendojë punën me Shërbimin Social Shtetëror, për të siguruar që shërbimet të jenë të përputhshme me standardet kombëtare dhe të orientuara drejt nevojave reale të individëve.

Për të garantuar një administrim funksional, ligji parashikon ngritjen e strukturave të posaçme për kujdesin shoqëror brenda vetë bashkisë, si dhe njësi vlerësimi dhe referimi në çdo njësi administrative, në varësi të saj. Gjithashtu, parashikohet që për *çdo 6,000 deri në 10,000 banorë* të caktohet një punonjës social nga bashkia, për të siguruar mbulimin e duhur dhe përgjigje efektive ndaj nevojave sociale.

Nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcaktojnë funksionimin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe rolin kyç të drejtuesit të saj.

Sipas Nenet 47, struktura për shërbimet shoqërore pranë bashkisë ka një mandat të gjerë që shtrihet përtej shërbimeve sociale të zakonshme. Ajo është gjithashtu organi kryesor për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, duke ndërmarrë masa nëpërmjet koordinimit me drejtoritë e tjera bashkiake, mekanizmat vendorë të mbrojtjes, dhe institucione të tjera. Kjo strukturë raporton rregullisht kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një funksion thelbësor i saj është *ngritja e grupit teknik ndërsektorial* për mbrojtjen e fëmijës, si në nivel bashkie, ashtu edhe në nivel të njësive administrative, duke koordinuar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tij.

Ndërkohë, Neni 48 përcakton detyrat e drejtorit të kësaj strukture, i cili është autoriteti përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi masat e mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në vlerësimet e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe grupit teknik. Drejtori luan një rol kyç në miratimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndërsektoriale, në zbatim të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe në organizimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes 24-orëshe, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Po ashtu, ai është përgjegjës për prokurimin e shërbimeve që nuk mund të ofrohen nga strukturat shtetërore, për monitorimin e aksesit të fëmijëve në të drejta, dhe për raportimin periodik mbi veprimtarinë e njësive të mbrojtjes së fëmijës.

Referuar Ligjit për barazinë gjinore në Shqipëri, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me qeverinë qendrore dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e politikave të barazisë gjinore në territorin që mbulojnë. Ata kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave lokale të ndara sipas gjinisë dhe emërojnë nëpunës përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, duke siguruar një mekanizëm efektiv koordinimi dhe monitorimi.

3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.


ë) Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale

Bazuar në ligjet e marra në analizë dhe aktet nënligjore, bashkitë kanë detyrimin të ofrojnë këto lloje të shërbimeve sociale për grupet në nevojë:

A. Shërbime për fëmijët




Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sidomos nenet 32-39, që parashikojnë shërbimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje, kujdes alternativ dhe përfshirje sociale.
- ✓ Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcaktojnë detyrimet e bashkive për shërbimet për fëmijët.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet psiko-sociale.

- ✓ Udhëzimi nr. 33, datë 23.11.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”, i cili rregullon shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, përfshirë emergjencën dhe strehimin e përkohshëm.




B. Shërbime për persona me aftësi të kufizuara (PAK)




Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili përcakton të drejtën për shërbime sociale të përshtatura dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.
- ✓ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, sidomos nenet 6, 12, 16, 17, 22, 23, që detyrojnë bashkitë të ofrojnë shërbime për PAK sipas standardeve.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet e kujdesit në familje për PAK.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për PAK”.



Dokument referencë:

- ✓ Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcakton përgjegjësinë e bashkive për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, duke përfshirë kujdesin në banesë dhe strehimin afatgjatë.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.05.2015, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në institucione rezidenciale publike dhe jopublike për të moshuarit”.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet” – përfshin edhe qendrat ditore dhe shërbimet në banesë për të moshuarit.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, e cila thekson zgjerimin e shërbimeve komunitare për të moshuarit, veçanërisht për ata pa mbështetje familjare.
- ✓ Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar – thekson nevojën për mbështetje për shtresat vulnerabël, përfshirë të moshuarit.



Dokumenta referencë:

- Ligj Nr.9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar).
- VKM Nr. 327, Datë 2.06.2021 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës Ndërmjet Autoriteteve Përgjegjëse për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, si dhe Procedimin e tij për Mbështetjen e Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës”.

3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve

Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

- **Në shërbimet shoqërore publike** përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.


- **Shërbimet jopublike** klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.
- **Shërbimet shoqërore të specializuara** janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë

Sipas Ligjit nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social” dhe Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, çdo shërbim social duhet të ketë të paktën një punonjës social të licencuar, i cili është përgjegjës për vlerësimin, planifikimin, ndjekjen dhe dokumentimin e ndërhyrjeve. Punonjësit socialë duhet të jenë të diplomuar në fushën përkatëse dhe të kenë licencë aktive nga Urdhri i Punonjësit Social. Në rastin e shërbimeve për fëmijë, përfshihet edhe psikologu me përvojë në çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve

Bashkia Mat ka prioritet zgjerimin e hartës së shërbimeve me shërbimet:



4. Analiza e të dhënave- vështrim i përgjithshëm



Në kuadër të vlerësimit të situatës sociale në territorin e Bashkisë Mat, të dhënat tregojnë praninë e kategorive të ndryshme të individëve që përballen me një ose më shumë forma cenueshmërie sociale, edhe pse në shumë raste mungojnë shifra të plota dhe të përditësuara zyrtare. Këta individë përfaqësojnë grupe të cenueshme që, për shkak të kushteve ekonomike, shëndetësore apo sociale, kanë nevojë për ndërhyrje të strukturuar përmes sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesjes sociale në nivel vendor.

Cenueshmëria në Bashkinë Mat ndikohet nga një sërë faktorësh ndërthurës, përfshirë:

- strukturën demografike të plakur të popullsisë,
- nivelin e lartë të papunësisë,
- mungesën e shërbimeve të specializuara,
- emigracionin masiv të të rinjve dhe familjeve,
- si edhe fragmentimin social pas migrimit apo divorcit.

Përveç kësaj, në territor identifikohen edhe raste të veçuara të personave me varësi ndaj substancave psikoaktive, si dhe mungesë e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, të cilët shpesh mbeten të paintegruar në rrjetin ekzistues të shërbimeve.

Grupet prioritare që kërkojnë vëmendje të veçantë përfshijnë:

- **Personat me aftësi të kufizuara**, të cilët kanë nevojë për mbështetje të personalizuar dhe përfshirje të qëndrueshme në jetën komunitare. Edhe pse të dhënat për ta nuk janë të detajuara në dokumentin bazë, praktika në bashki të tjera sugjeron që kjo kategori përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të nevojave sociale në territor.
- **Fëmijët në rrezik dhe pa kujdes prindëror**, Bashkia Mat, në kuadër të strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, ka të punësuar 1 (një) Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), i cili mbulon të gjithë territorin e bashkisë.
- Për të përballuar nevojat në rritje për shërbime të mbrojtjes së fëmijëve, me urdhër të brendshëm, punonjësve të ndihmës ekonomike në njësitë administrative u është ngarkuar si detyrë funksionale shtesë edhe roli i PMF-së.
- **Të moshuarit pa përkujdesje**, të cilët përballen me mungesë shërbimesh në komunitet dhe kanë nevojë për modele të reja të kujdesit në shtëpi apo në qendra ditore.
- **Familjet me të ardhura të pamjaftueshme**, që shpesh janë përfitues të ndihmës ekonomike, por nuk kanë akses në mbështetje për vetëpunësim ose integrim në tregun e punës.
- **Viktimat e dhunës në familje**, të cilët nuk rezultojnë të përfshira në skema mbështetëse të integruara.
- **Komunitetet rom dhe egjiptian**, që nuk janë aktualisht të regjistruar në territorin e Bashkisë Mat, por përfshihen si kategori prioritare sipas politikave kombëtare të përfshirjes sociale dhe duhet të jenë pjesë e mekanizmave të vlerësimit të vazhdueshëm të nevojave.

Kjo situatë reflekton një kompleksitet të lartë të nevojave sociale dhe nënvizon domosdoshmërinë për ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të integruar në ofrimin e shërbimeve. Hartimi i planeve të ndërhyrjes duhet të bazohet në analiza të sakta të shpërndarjes gjeografike dhe karakteristikave të grupeve vulnerabël, në mënyrë që burimet njerëzore, infrastrukurore dhe financiare të orientohen aty ku nevoja është më e madhe. Për më tepër, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe krijimi i mekanizmave funksionale të referimit dhe ndjekjes janë thelbësore për rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale në Bashkinë Mat.

4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë

Sipas të dhënave më të fundit, Bashkia Mat ka një popullsi totale prej **17,405 banorësh**, me një shpërndarje të balancuar gjinore: **8,617 femra** dhe **8,788 meshkuj**. Kjo popullsi është e shpërndarë në tetë njësi administrative: Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Komsi, Lis, Ulëz dhe Macukull.

Qendra më e populluar është **Njësia Administrative Burrel**, me rreth **7,928 banorë** (3,934 femra dhe 3,994 meshkuj), ndjekur nga **Komsi** (2,809 banorë), **Lis** (2,359), **Baz** (1,270), **Rukaj** (1,209), **Ulëz** (661), **Macukull** (656), dhe **Derjan** (513).

5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese

5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative

Në analizën e shpërndarjes territoriale të individëve përfitues të ndihmës ekonomike në Bashkinë Mat, vihet re një përqendrim i lartë përfituesish në disa njësi administrative të veçanta, duke reflektuar shpërndarjen jo të barabartë të varfërisë dhe nevojave ekonomike brenda territorit.

Dy njësitë administrative me numrin më të lartë të përfituesve janë:

- **Burrel me 1,589 individë**, dhe
- **Komsi me 909 individë**.


Këto njësi përfaqësojnë qendra të rëndësishme banimi dhe ekonomike brenda bashkisë, por gjithashtu janë edhe zona me ngarkesë të lartë sociale, ku varfëria dhe papunësia janë më të përhapura. Ndihma ekonomike në këto zona përbën një instrument të rëndësishëm për mbështetjen e jetesës, por nga ana tjetër thekson nevojën për politika aktive të punësimit dhe integritimit social.

Në vijim renditen:

- **Lis me 903 përfitues**,
- **Rukaj me 820 përfitues**,
- **Baz me 935 përfitues**,
- **Macukull me 338 përfitues**,

- **Derjan** me 307 përfitues, dhe
- **Ulëz** me 196 përfitues.

Këto të dhëna sugjerojnë që ndërhyrjet e Bashkisë duhet të kenë një qasje të diferencuar territoriale, duke u fokusuar në zonat me ngarkesë më të lartë sociale përmes një kombinimi të ndihmës ekonomike, formimit profesional, përfshirjes në ekonominë sociale dhe fuqizimit të rrjeteve të kujdesit social.



5.2 Individë përfitues sipas gjinisë

Të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit e ndihmës ekonomike në Bashkinë Mat tregojnë një shpërndarje relativisht të barabartë midis burrave dhe grave, me një diferencë të vogël në favor të meshkujve:

- **Meshkuj:** 3,104 përfitues
- **Femra:** 2,993 përfitues

Kjo shpërndarje sugjeron se varfëria dhe nevoja për mbështetje ekonomike prek në mënyrë të ngjashme të dyja gjinitë, megjithatë vlen të theksohet se **gratë në varfëri shpesh përballen me sfida të shumfishta** që lidhen me kujdesin për fëmijët, mungesën e mundësive për punësim, varësinë ekonomike, dhe rrezikun më të lartë për përjashtim social, veçanërisht në zonat rurale.



5.3 Individë përfitues sipas grupmoshës

Ndarja e përfituesve të ndihmës ekonomike sipas grupmoshës në Bashkinë Mat jep një pasqyrë të qartë të profilin social dhe demografik të popullsisë që mbështetet nga skema e ndihmës ekonomike. Të dhënat janë si më poshtë:

- **0–18 vjeç:** 1,816 individë
- **19–64 vjeç:** 3,816 individë
- **Mbi 65 vjeç:** 357 individë

Kjo shpërndarje tregon se **rreth 64% e përfituesve janë në moshë pune (19–64 vjeç)**, gjë që nënvizon sfidat strukturore që lidhen me mungesën e mundësive për punësim, aftësimin profesional të pamjaftueshëm, dhe varësinë nga ndihma sociale për moshat aktive. Ky është një sinjal i qartë për nevojën e **politikave të punësimit dhe fuqizimit ekonomik**, sidomos për të rinjtë dhe gratë që janë pjesë e kësaj grupmoshe.

Grupi 0–18 vjeç përbën një përqindje të konsiderueshme të përfituesve, çka tregon se një pjesë e fëmijëve jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe si të tillë, janë potencialisht të ekspozuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit social. Kjo shton domosdoshmërinë për:

- ndërhyrje mbështetëse për familjet me fëmijë,
- sigurimin e aksesit në edukim, shërbime mbështetëse dhe ushqim të shëndetshëm,
- si dhe identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.

Numri më i ulët i përfituesve është në grupmoshën mbi 65 vjeç, me **vetëm 357 individë**, gjë që mund të reflektojë aksesin e kësaj grupmoshe në skemat e pensioneve, por gjithashtu nënvizon edhe mundësinë që një pjesë e të moshuarve nuk janë të përfshirë në skema mbështetëse për shkak të mungesës së informacionit apo kufizimeve në lëvizshmëri dhe akses në shërbime.

5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike

Gjatë vitit 2024, në territorin e **Bashkisë Mat** kanë aplikuar për përfitim të ndihmës ekonomike gjithsej **1,495 familje**, të shpërndara në njësitë administrative. Kjo shifër pasqyron një **kërkesë të konsiderueshme për mbështetje ekonomike**, duke nënvizuar nevojën për **ndërhyrje sociale të qëndrueshme dhe të strukturuar**, me fokus në reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit.

□ **Zonat me numrin më të lartë të aplikimeve janë:**

- **Burrel** – 570 familje
- **Baz** – 250 familje
- **Lis** – 248 familje
- **Komsi** – 278 familje

- **Macukull** – 93 familje

Këto njësi përfaqësojnë zona me përqendrim të lartë popullsie dhe sfida të theksuara sociale e ekonomike. Aplikimet e shumta në këto zona tregojnë për nevoja të thella për mbështetje dhe orientim drejt mekanizmave të mbrojtjes sociale.



□ Zona me numrin më të ulët të aplikimeve:

- **Ulëz** – 56 familje

Numri më i ulët i aplikimeve në Ulëz mund të lidhet me përmasat më të vogla të popullsisë, por gjithashtu kërkon **analizë të thelluar** mbi aksesin në informacion, ndërgjegjësimin e komunitetit dhe mundësinë e ekzistencës së barrierave administrative që pengojnë aplikimin.

5.5 Familjet përfituese të ndihmë ekonomike


Sipas të dhënave të mbledhura nga Bashkia Mat për vitin 2024, në total **1,490 familje** përfitojnë aktualisht nga skema e ndihmës ekonomike. Këto familje janë të shpërndara në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, me përqendrim të ndryshme që pasqyrojnë karakteristikat sociale dhe ekonomike të secilës zonë.

Shpërndarja territoriale:

- **Burrel** ka numrin më të lartë të familjeve përfituese me **460 raste**, duke reflektuar rolin e saj si qendër urbane dhe zonë me sfida të theksuara sociale, si papunësia dhe mungesa e mundësive ekonomike për familjet në nevojë.
- **Lis (228 familje)** dhe **Komsi (211 familje)** renditen menjëherë pas, duke treguar gjithashtu nivele të konsiderueshme të varfërisë dhe nevojës për mbështetje të vazhdueshme.
- **Baz (215 familje)** dhe **Rukaj (160 familje)** përfaqësojnë zona me densitet më të ulët por me ngarkesë sociale të qëndrueshme, ku varfëria strukturore mbetet një sfidë.
- **Macukull (83 familje)** dhe **Derjan (79 familje)** paraqesin gjithashtu përqindje të larta për popullsinë që mbulojnë.
- **Ulëz, me 54 familje përfituese**, ka numrin më të ulët në territor, megjithatë kërkon monitorim të vazhdueshëm për të siguruar mosmbetjen jashtë skemës të familjeve në nevojë për shkak të mungesës së informimit apo pengesave administrative.

5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike

Të dhënat e mbledhura nga Bashkia Mat mbi familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike pasqyrojnë një tablo të qartë të grupeve në nevojë në territorin e bashkisë. Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e profilit social të përfituesve dhe në planifikimin e politikave sociale të synuara.



5.6.1 Familjet me të paktën një pjesëtar në moshë pensioni

Kjo kategori përbën një përqindje të konsiderueshme në të gjitha njësitë, duke reflektuar një nevojë të vazhdueshme për mbështetje për të moshuarit në pension, të cilët shpesh nuk kanë burime të tjera të ardhurash. Numri më i lartë i familjeve të tilla është regjistruar në Lis (36 familje), Koms (23), dhe Burrel (28). Kjo sugjeron se këto njësi duhet të kenë ndërhyrje të dedikuara për mbështetje të të moshuarve, përfshirë shërbime në komunitet dhe transport të asistuar.

5.6.2 Familjet me të paktën një anëtar PAK

Prania e familjeve me persona me aftësi të kufizuara është më e larta në Burrel (61 familje), Lis (41) dhe Koms (37). Kjo nënvizon rëndësinë për shërbime të aksesueshme, përfshirje sociale dhe punësim të asistuar për këtë kategori, në veçanti në këto zona ku përqendrimi është më i lartë.

5.6.3 Familjet Rome ose Egjiptiane

Përqendrimi më i madh i familjeve Rome ose Egjiptiane përfituese ndihme ekonomike gjendet në Burrel (75 familje) dhe në një masë më të vogël në Koms (8) dhe Baz (5). Këto të dhëna kërkojnë masa të posaçme për përfshirjen sociale të këtyre komuniteteve, përfshirë edukimin, strehimin dhe shëndetin.

5.6.4 Familjet me deri në 2 fëmijë të mitur

Ky është një indikator i rëndësishëm i nevojës për mbështetje të hershme dhe kujdes për fëmijët. Numri më i lartë i familjeve në këtë kategori është regjistruar në Burrel (255 familje), Baz (110), Lis (96) dhe Koms (58). Tregues i qartë se këto zona duhet të përfitojnë më shumë nga politikat për kujdesin ndaj fëmijëve, përfshirë aksesin në shërbime arsimore cilësore dhe ushqim të shëndetshëm.

5.6.5 Familjet ku kryefamiljare është një grua

Përqindja e lartë e grave kryefamiljare përfituese në Burrel (80), Komsë (35) dhe Baz (20) tregon për sfidat që hasin gratë në drejtimin e familjes në mungesë të një figure tjetër mbështetëse. Nevojitet një fokus i veçantë për fuqizimin ekonomik dhe përkrahjen e grave në rolin e kryefamiljares, përmes trajnimeve dhe aksesit në punësim.



6. Strehimi Social


6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social

Gjatë vitit 2024, në Bashkinë Mat kanë aplikuar gjithsej **338 familje për përfitim nga programet e strehimit social**.

Kjo shifër dëshmon për nevojën të vazhdueshme për mbështetje me strehim të përballueshëm, veçanërisht për familjet në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.

□ Shpërndarja sipas njësive administrative:

- Burrel – 265 familje
- Komsë – 21 familje
- Baz – 18 familje
- Lis – 17 familje
- Rukaj – 8 familje
- Macukull – 4 familje
- Derjan – 3 familje
- Ulëz – 1 familje



Burrel përbën mbi 78% të totalit të aplikimeve, duke reflektuar përqendrimin më të madh të popullsisë dhe nivelin më të lartë të kërkesës për strehim në këtë zonë urbane. Në njësitë rurale si Rukaj, Derjan, Macukull dhe Ulëz, numri i aplikimeve është dukshëm më i ulët, çka mund të lidhet me faktorë si mungesa e informimit, stoku i kufizuar i banesave sociale ose dinamika e migrimit.

Këto të dhëna nënvizojnë domosdoshmërinë për të rishikuar dhe përforcuar politikat e strehimit, me qëllim garantimin e qasjes së barabartë për të gjitha kategoritë vulnerabël në territorin e bashkisë.


6.2 Numri i familjeve përfituese për strehim social

Gjatë vitit 2024, nga programet e strehimit social në Bashkinë Mat kanë përfituar gjithsej **82 familje**, të shpërndara në shtatë njësi administrative. Këto përfitime përfshijnë mbështetje në formën e subvencionimit të qirasë ose vendosje në banesa sociale, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për strehimin.

Shpërndarja sipas njësive administrative:

- **Burrel** – 69 familje
- **Komsi** – 4 familje
- **Baz** – 4 familje
- **Lis** – 2 familje
- **Rukaj** – 1 familje
- **Derjan** – 1 familje
- **Macukull** – 1 familje
- **Ulëz** – 0 familje

Familjet përfituese nga strehimi social sipas njësive administrative
Bashkia Mat, 2024



Shumica dërmuese e përfituesve ndodhen në **Burrel**, që përfaqëson jo vetëm zonën me popullsinë më të madhe, por edhe me **kërkesën më të lartë për strehim social**. Njësitë e tjera, veçanërisht zonat rurale si **Ulëz, Rukaj, Derjan** dhe **Macukull**, kanë një numër shumë të kufizuar përfituesish, çka mund të lidhet me mungesë stoku të banesave sociale ose me kritere të forta përzgjedhjeje.

Këto të dhëna tregojnë nevojën për:

- Rritjen e kapaciteteve për strehim social në zonat rurale,
- Monitorimin e përputhshmërisë midis kërkesës dhe ofrimit, dhe
- Hartimin e politikave më të balancuara që garantojnë **akses të barabartë në mbështetje për strehim** për të gjitha kategoritë në nevojë.

6.3 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike

Nga të dhënat e vitit 2024, rezulton se 34 familje në Bashkinë Mat përfitojnë njëkohësisht nga programet e strehimit social dhe nga skema e ndihmës ekonomike. Ky grup përfaqëson segmentin më vulnerabël të popullsisë, që përballon njëkohësisht vështirësi ekonomike dhe mungesë strehimi të qëndrueshëm, duke kërkuar mbështetje të integruar nga institucionet vendore.


Shpërndarja sipas njësive administrative:

- Burrel – 31 familje
- Lis – 1 familje
- Derjan – 1 familje

- Macukull – 1 familje
- Koms, Baz, Rukaj dhe Ulëz – 0 familje



Familjet që përfitojnë si nga strehimi social ashtu edhe nga ndihma ekonomike
Bashkia Mat, 2024



□ Shumica dërmuese e përfituesve ndodhen në Burrel, që njëkohësisht është zona me përqendrim më të madh të popullsisë dhe me sfidat më të theksuara sociale. Për njësitë administrative që nuk paraqesin përfitues të kësaj kategorie, është e rëndësishme të analizohen arsyet e mungesës së aplikimeve të kombinuara ose barrierat e mundshme për përfshirjen në programet e dyfishta të mbështetjes.

□ Rekomandohet që për familjet në situata të tilla të krijohen mekanizma të integruar të identifikimit, trajtimit dhe mbështetjes për të garantuar mbrojtje sociale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

6.4 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare

Bazuar në të dhënat e paraqitura për **godinat me infrastrukturë të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve komunitare** në Bashkinë Mat, vihet re një **mungesë e theksuar e kapaciteteve infrastrukturore** në pjesën më të madhe të njësive administrative:

- **7 nga 8 njësi administrative** (Ulëz, Lis, Koms, Macukull, Rukaj, Derjan, Baz) **nuk kanë asnjë godinë** të përshtatur për ofrimin e shërbimeve komunitare.
- Vetëm **njësia administrative Burrel** rezulton me **2 godina të përshtatshme** për këtë qëllim.

6.5 Familje përfituese sipas programeve të strehimit

Në Bashkinë Mat janë zbatuar **tre programe të strehimit social**, nga të cilat kanë përfituar gjithsej **82 familje**.

Këto programe synojnë mbështetjen e familjeve në nevojë për të siguruar strehim të qëndrueshëm dhe të përballueshëm, në përputhje me kuadrin ligjor për strehimin social në Shqipëri.

□ Përfituesit sipas programeve:

1. □ **Banesë sociale me qira – 26 familje**


Ky program u mundëson familjeve të strehohen në banesa në pronësi të bashkisë ose të institucioneve publike me qira të subvencionuar.

2. □ **Banesë me kosto të ulët – 25 familje**

Familjeve në nevojë u ofrohet mundësia për të përfituar nga skemat për banesa me çmim të reduktuar nëpërmjet bashkëfinancimit publik.

3. □ **Subvencion i qirasë në tregun e lirë – 31 familje**

Ky program ofron mbështetje financiare për pagesën e qirasë për familjet që nuk kanë mundësi të sigurojnë banesë në treg të lirë.



□ Të dhënat tregojnë se **programi i subvencionit të qirasë** është më i përdoruri në nivel vendor, ndjekur nga banesat sociale dhe ato me kosto të ulët.

Ky konfigurim nënvizon **nevojën për fleksibilitet në politikat e strehimit**, duke u përshtatur me karakteristikat socio-ekonomike të përfituesve dhe mundësitë e bashkisë për të ofruar forma të ndryshme mbështetjeje.



7. Punëkërkuesit e papunë në Bashkinë Mat

Të dhënat mbi punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punës tregojnë disa dinamika të rëndësishme, si në nivel të përgjithshëm bashkie, ashtu edhe në ndarje sipas kategorive të veçanta dhe njësive administrative.

7.1 Të dhëna të përgjithshme:

- **Numri total i femrave të regjistruara si punëkërkuese** është më i lartë se ai i meshkujve: **934 femra kundrejt 801 meshkujve**, duke sugjeruar një pabarazi gjinore në aksesin në punësim dhe nevojën për politika të targetuara për fuqizimin ekonomik të grave.
- **Grupet më të rrezikuara përfshijnë:**
 - **Personat me aftësi të kufizuara (PAK):** 213 raste
 - **Gra kryefamiljare:** 25 raste
 - **Individë të komunitetit rom/egjiptian:** 30 raste
 - **Emigrantë të rikthyer:** 20 raste

Këto kategori përfaqësojnë grupe me rrezik të lartë për përjashtim nga tregu i punës dhe kërkojnë mbështetje specifike për integrim social dhe ekonomik.

7.2 Ndarja sipas njësive administrative:

- Burreli përqendron pjesën më të madhe të punëkërkuesve në bashki me 981 persona të regjistruar, çka tregon rëndësinë për ndërhyrje me programe të përqendruara në këtë zonë urbane.
- Pasuar nga:
 - Koms (96 punëkërkues)
 - Lis (66) dhe Rukaj (65)
- Macukull dhe Derjan shfaqin nivele më të ulëta të papunësisë së regjistruar, përkatësisht me 10 dhe 17 persona, por kjo nuk përjashton nevojën për ndërhyrje, sidomos nëse papunësia është strukturore apo afatgjatë.

Të dhënat nënvizojnë nevojën për:

- Zhvillimin e programeve të punësimit të targetuar, veçanërisht për gratë, PAK dhe komunitetet e marginalizuara;
- Nxitjen e punësimit në njësitë me përqendrim të lartë papunësie si Burrel, Koms dhe Lis;

- Forcimin e bashkëpunimit mes bashkisë dhe zyrës së punës, si dhe ngritjen e formave të ndërmjetësimit të punës në nivel komunitar.



7.3 Situata e Punëkërkuesve dhe Ndihmës Ekonomike

- **Numri i individëve me ndihmë ekonomike të regjistruar në zyrën e punës: 879**
Këta janë persona që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe janë të regjistruar si punëkërkues aktivë.
- **Numri i individëve me ndihmë ekonomike, në moshë pune: 2,042**
Tregon potencialin e papërdorur të fuqisë punëtore në nevojë, që janë aktualisht përfitues të ndihmës ekonomike dhe në moshë pune. Diferenca midis këtij numri dhe atyre të regjistruar në zyrën e punës (879) tregon një **mospërputhje të madhe** në përfshirjen e tyre në shërbime të punësimit.
- **Totali i punëkërkuesve të papunë: 1,315**
Ky numër përfshin individë që mund të mos jenë përfitues të ndihmës ekonomike, por janë të papunë dhe aktivë në kërkimin e punës.

Ka një potencial të pashfrytëzuar për të përfshirë më shumë individë në moshë pune, veçanërisht përfitues të ndihmës ekonomike, në programet e punësimit dhe regjistrimin në zyrat përkatëse. Rreth 57% e përfituesve në moshë pune nuk janë të regjistruar si punëkërkues aktivë.

7.4 Trajnimet Profesionale

- Numri i trajnimeve profesionale të ofruara nga zyra e punës: 10
- Numri i përfituesve nga trajnimet profesionale: 324
- Çdo trajnim ka pasur mesatarisht rreth 32 përfitues, që tregon se trajnimet kanë pasur shtrirje të gjerë, por edhe nevojë për më shumë diversifikim në profile dhe numër trajnimesh.
- Numri i rasteve të ndërmjetësimit për punësim: 92
Ky numër është dukshëm më i ulët në krahasim me kërkesën – vetëm 7% e punëkërkuesve janë ndërmjetësuar për punë (92 nga 1,315), gjë që tregon për efikasitet të ulët të ndërmjetësimit ose për mungesë të ofertave të përshtatshme në treg.

Bashkia Mat ka vendosur bashkëpunime të rëndësishme me institucione të ndryshme publike për të lehtësuar përfshirjen e grupeve vulnerabël në tregun e punës dhe në programet e aktivizimit social. Këto institucione ofrojnë një gamë shërbimesh publike, brenda të cilave është mundësuar angazhimi përmes praktikave, punës komunitare apo nismave për nxitjen e punësimit.

Lista e institucioneve bashkëpunuese:

- Bashkia Mat
- Drejtoria e Shërbimit Spitalor
- Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor



Llojet e trajnimeve dhe angazhimeve të ofruara

Bashkia Mat, në kuadër të **“Programeve të Nxitjes së Punësimit”**, ka zbatuar dy forma kryesore të angazhimit profesional për persona në nevojë ose grupe vulnerabël:

1. **Punë publike në komunitet (PPK)** – në bashkëpunim me institucionet vendore, përfshirë Bashkinë Mat, duke mundësuar angazhimin e individëve në detyra të dobishme për komunitetin.
2. **Praktikë profesionale** – përmes programeve të integruara që lidhen me përgatitjen për tregun e punës, gjithashtu në partneritet me Bashkinë Mat.

7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Mat

Bazuar në të dhënat për **numrin e bizneseve sipas njësive administrative në Bashkinë Mat**, vihet re një përqendrim i ndjeshëm i aktivitetit ekonomik në qytetin e **Burrelit**, ndërkohë që pjesa më e madhe e njësive të tjera kanë një numër shumë të ulët biznesesh.

Njësia Administrative	Nr. i Bizneseve	Analizë
Burrel	400	Qendra kryesore urbane dhe ekonomike e bashkisë – dominon dukshëm në aktivitetin ekonomik
Komsi	33	Nivel mesatar – potencial për zhvillim më të madh
Lis	15	Niveli i ulët i biznesit, por me prani të moderuar krahasuar me zonat e tjera rurale
Ulëz	11	Aktivitet modest – mundësi për mbështetje agrobiznesi/turizmi natyror
Baz	4	Aktivitet shumë i kufizuar
Rukaj, Macukull	nga 2	Prani minimale biznesi
Derjan	0	Mungesë totale aktiviteti ekonomik të regjistruar

Nga analiza e të dhënave vihet re:

1. Pabarazi e theksuar në shpërndarjen e bizneseve – mbi 85% e bizneseve ndodhen vetëm në qytetin e Burrelit, duke lënë njësitë e tjera në kushte të vështira zhvillimi ekonomik.


2. Zonat rurale janë të nënpërfaqësuar ekonomikisht, duke treguar mungesë investimesh, mbështetje për sipërmarrje ose mundësi të kufizuara tregu.
3. Derjan ka mungesë të plotë të aktivitetit biznesor, çka tregon nevojën për ndërhyrje emergjente në formë programesh zhvillimi rural, subvencione për bujqësi apo mbështetje për agroturizëm.
4. Potencial i pashfrytëzuar në njësi si Komsì, Lis dhe Ulëz, ku ka prani të moderuar biznesi dhe mund të nxiten forma të reja të sipërmarrjes lokale.



8. Personat me Aftësi të Kufizuara

Një ndër aspektet më të rëndësishme në planifikimin social vendor është kuptimi i shpërndarjes së grupeve vulnerabël në territor. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) përbëjnë një kategori që kërkon vëmendje të veçantë, qasje gjithëpërfshirëse dhe shërbime të integruara. Të dhënat e mbledhura nga njësitë administrative të Bashkisë Mat ofrojnë një panoramë të qartë mbi përhapjen e PAK-ve sipas karakteristikave funksionale – konkretisht ata me kufizime fizike/mendore, me paratetraplegji dhe me probleme shikimi.

8.1 Karakteristikat e Aftësisë së Kufizuar



Të dhënat tregojnë se:

- **Burrel** ka numrin më të lartë absolut të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha kategoritë funksionale:
 - 223 persona me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore,
 - 19 persona paratetraplegjikë,

- 69 persona me probleme shikimi.

Kjo është një pasqyrë e natyrshme për një zonë qendrore urbane me popullsi më të madhe dhe akses më të mirë në sistemin e regjistrimit.

- **Komsi (113 raste), Lis (102 raste) dhe Baz (90 raste)** paraqesin një prani të konsiderueshme të PAK-ve, veçanërisht në kategorinë e kufizimeve fizike/mendore. Këto tregojnë nevojën për zgjerimin e shërbimeve mbështetëse në zonat rurale me përqendrim të lartë të popullsisë.
- **Rukaj, Macukull, Derjan dhe Ulëz** kanë një numër më të ulët të PAK-ve në terma absolutë, por për shkak të popullsisë së vogël, prevalenca mund të jetë domethënëse. Në këto zona rekomandohet orientimi drejt **shërbimeve të lëvizshme (mobile)** dhe qasjeve fleksibël për të garantuar përfshirjen sociale të tyre.

Në të gjitha njësitë administrative, dominojnë rastet me kufizime fizike dhe mendore, ndërkohë që nuk mungojnë edhe rastet e paratetraplegjisë apo të problemeve me shikimin, të cilat kërkojnë ndërhyrje më të specializuara, akses në pajisje ndihmëse, terapi, orientim profesional dhe mbështetje për autonomi.

Përhapja e rasteve të problemeve me shikimin është veçanërisht e lartë në Burrel, Komsi dhe Rukaj – zonat që duhen prioritetizuar për ndërhyrje me teknologji ndihmëse, edukim të përshtatur dhe përfshirje në jetën komunitare.

8.2 Shërbimi i strehimit social

Aktualisht, në Bashkinë Mat janë identifikuar **13 familje përfituese nga programet e strehimit social**, të cilat kanë **në përbërje persona me aftësi të kufizuara (PAK)**.

Kjo kategori përfaqëson një **prioritet të veçantë në politikat sociale vendore**, pasi përfshin individë që përballen me **barriera të shumëfishta** – ekonomike, shëndetësore dhe të aksesit në infrastrukturë.

Mbështetja për këto familje është jetike për të garantuar **jetesë të dinjitetshme dhe gjithëpërfshirëse**, në përputhje me parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe ligjin shqiptar për strehimin social.

8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës

Numri i vetë raportuar i **invalidëve të punës që trajtohen përmes skemës së mbrojtjes sociale është 55**. Më konkretisht:

- Rukaj ka numrin më të lartë me 30 përfitues, duke përfaqësuar mbi gjysmën e totalit.
- Derjan renditet i dyti me 13 përfitues.
- Macukull ndjek me 12 përfitues.
- Njësitë Burrel, Baz, Komsi, Lis dhe Ulez nuk kanë përfitues të raportuar nga kjo skemë.

8.5 Qendrat zhvilluese dhe rehabilituese sociale për individët me PAK

Në territorin e Bashkisë Mat është identifikuar një (1) qendër që ofron shërbime të strukturuar, për individët me aftësi të kufizuara:




- **Qendra Ditore “Shpresa e Re”**, me administratore znj. Elona Livani
- **Numri i përfituesve:** 40 individë me PAK
- **Shërbimet që ofrohen:**
 - a) Përkujdesje komunitare
 - b) Ushqim dhe higjienë personale
 - c) Terapi dhe animacion

8.6 Shërbimi Shëndetësor

Ky grafik paraqet shpërndarjen e strukturave shëndetësore (Qendra Shëndetësore, Ambulanca, Poliklinika) sipas njësive administrative në Bashkinë Mat. Siç mund të shihet:

- **Ambulancat** janë të pranishme në thuajse çdo njësi administrative, me numër më të lartë në Rukaj (11), Lis (10) dhe Komsí (9).
- **Qendrat Shëndetësore** janë të pranishme vetëm në 5 nga 8 njësitë.
- **Poliklinikat** mungojnë plotësisht në të gjitha njësitë.

Kjo shpërndarje sugjeron nevojën për përf forcimin e infrastrukturës shëndetësore të nivelit të mesëm dhe të avancuar, veçanërisht në zonat ku mungojnë qendrat shëndetësore dhe ku ka mbështetje vetëm nga ambulanca.



8.6 Treguesit Kryesorë të Shëndetit në Bashkinë Mat

Bazuar në të dhënat e paraqitura për treguesit e shëndetit dhe mirëqenies fizike/mendore, vihet re një situatë e përzier, ku bashkëjetojnë elementë pozitivë me boshllëqe të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.



Nga njëra anë, kapaciteti i infrastrukturës spitalore është i dukshëm, me 162 shtretër dhe 97 personel mjekësor e infermieror në funksion, si dhe me prani spitali në qytet. Gjithashtu, niveli i vaksinimit të fëmijëve është shumë i lartë (99%), ndërsa norma e vdekshmërisë foshnjore është zero – të dy këta tregues flasin për funksionimin relativisht të mirë të sistemit bazë të kujdesit shëndetësor.

Nga ana tjetër, shqetësim mbetet mungesa e plotë e psikologëve në qendrat shëndetësore, përballë një numri të lartë rastesh të trajtuara për probleme të shëndetit mendor (169 raste). Po ashtu, evidentohen 10 fëmijë të diagnostikuar me autizëm dhe 58 fëmijë me çrregullime të tjera zhvillimore, çka tregon për domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të strukturuar në këtë fushë.

Me 627 vizita për shëndetin riprodhues gjatë vitit 2024, vihet në dukje ndërgjegjësimi dhe kërkesa për kujdes shëndetësor të specializuar për gratë dhe çiftet, por mungesa e mbështetjes psikologjike dhe psiko-sociale i lë këto përpjekje të paplota.

9. Viktima të dhunës në familje

9.1 Mekanizmit Lokal për Dhunën në Familje

Mekanizmi lokal për identifikimin dhe adresimin e nevojave të viktimave të dhunës në familje në Bashkinë Mat përfaqëson një strukturë të institucionalizuar bashkëpunimi ndërsektorial dhe ndërinstitutional, e ngritur për të garantuar një qasje të koordinuar dhe të integruar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ai funksionon në nivel lokal dhe synon identifikimin e hershëm, mbrojtjen efektive dhe rehabilitimin e plotë të viktimave, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e tyre.

Ky mekanizëm bazohet në një qasje **multidisiplinare**, që do të thotë se sjell bashkë përfaqësues nga sektorë të ndryshëm për të analizuar rastet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke vlerësuar rrezikun, nevojat, dhe mbështetjen e nevojshme për secilën situatë. Anëtarët e tij janë të angazhuar në procesin e identifikimit të rasteve, vlerësimit të rrezikut dhe hartimit të **Planit Individual të Mbrojtjes**, si dhe në ndjekjen e koordinuar të rasteve deri në mbyllje të plotë apo rehabilitim të viktimës.


Mekanizmi përfshin aktorë të ndryshëm lokalë, si:

- **Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe punonjësit socialë të bashkisë**, që kryejnë identifikimin fillestar dhe referimin e rasteve.
- **Policia vendore**, që garanton sigurinë dhe merr masa ligjore për urdhrat e mbrojtjes.
- **Mjekët e familjes dhe qendrat shëndetësore**, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e shenjave të dhunës fizike dhe dhënien e kujdesit mjekësor.

- **Shërbimet ligjore falas dhe organizatat e shoqërisë civile**, që ofrojnë mbështetje ligjore, psikologjike dhe strehim emergjent për viktimat.
- **Spitali dhe NjVKSh Mat**, që ofrojnë ndërhyrje të specializuara mjekësore dhe psikosociale.
- **Zyra e Punës**, për rehabilitimin ekonomik dhe përfshirjen e viktimave në programe të punësimit apo trajnimeve.
- **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Dibër**, për ndihmën ekonomike dhe mbështetjen me shërbime sociale.
- **Zyra Përmbarimore dhe Nënprefektura**, që ndihmojnë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe koordinimin ndërinstitucional.
- **Zyra Arsimore**, e cila luan rol në parandalimin e dhunës përmes ndërgjegjësimit në shkolla dhe mbështetjes për fëmijët e përfshirë në raste të tilla.



9.2 Dhuna në Familje sipas Njësive Administrative



Grafiku i mësipërm paraqet shpërndarjen e rasteve të dhunës në familje sipas njësive administrative të Bashkisë Mat, duke përfshirë numrin e rasteve të raportuara, urdhrave të mbrojtjes të lëshuara dhe atyre të monitoruara:

- Njësitë administrative **Lis**, **Komsí** dhe **Burrel** kanë raportuar nga 3 raste të dhunës në familje, dhe për secilin prej tyre janë lëshuar dhe monitoruar gjithashtu 3 urdhra mbrojtjeje – kjo tregon një funksionim të plotë të mekanizmit lokal në këto zona.
- Në **Rukaj**, është raportuar vetëm 1 rast, i cili është ndjekur me një urdhër mbrojtjeje të lëshuar dhe të monitoruar.



- **Derjan** ka raportuar 1 rast, por personi ka kryer raportim në polici dhe ka paraqitur kërkesë në Gjykatë për heqje dorë.
- Në **Ulëz, Macukull, dhe Baz**, nuk është raportuar asnjë rast dhune dhe rrjedhimisht nuk ka urdhra mbrojtjeje të lëshuara apo monitoruara. Kjo mund të sinjalizojë ose mungesë rastesh, ose mungesë identifikimi dhe raportimi.

Kjo analizë ndihmon në identifikimin e njësive ku mekanizmi lokal funksionon më mirë dhe atyre ku duhen përforcuar kapacitetet për parandalim, raportim dhe ndjekje të rasteve të dhunës në familje.

9.3 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje

Të dhënat e mbledhura në nivel vendor tregojnë një situatë problematike në raport me mbështetjen konkrete të ofruar për viktimat e dhunës në familje. Edhe pse mekanizmi lokal për identifikimin dhe adresimin e rasteve të dhunës është në funksionim, shifrat e raportuara tregojnë se kapaciteti dhe mundësitë reale të reagimit dhe rehabilitimit janë ende të kufizuara.

Në mënyrë të veçantë, vërehet se:

- **Nuk ka pasur asnjë përfitues** nga kategoria “**Shërbime për fëmijët e viktimave të dhunës**”, duke nënkuptuar mungesën e strukturave ose ndërhyrjeve të posaçme që adresojnë nevojat e fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje.
- Po ashtu, nuk rezulton asnjë rast përfitues nga **shërbimet emergjente të strehimit** të ofruara nga bashkia, një tregues se bashkia ose nuk ka kapacitete për këtë shërbim, ose mekanizmi i referimit nuk është funksional.
- Të gjitha rastet janë **menaxhuar nga Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN)** dhe janë **referuar për ndihmë psikologjike** pranë psikologes së Spitalit që ofron shërbime për viktimat, si dhe **drejtuar pranë shërbimit ligjor falas në Burrel** për mbështetje juridike. Nga ana tjetër, disa shërbime kanë pasur një nivel më të lartë aktivizimi:
- **5 viktima kanë përfituar punësim**, që është një element kyç në fuqizimin ekonomik dhe pavarësimin e viktimave nga marrëdhëniet e dhunshme.
- **3 viktima kanë përfituar strehim social**, që mund të jetë i lidhur me strukturat e qëndrueshme ekzistuese, ndonëse jo emergjente.
- **3 viktima kanë përfituar ndihmë ekonomike**, e cila përbën një formë mbështetjeje bazike, por jo gjithmonë të mjaftueshme për të garantuar mbrojtje dhe rikuperim të plotë.



10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

10.1 Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve

Në përputhje me ligjin nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe udhëzimet përkatëse, **identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik** realizohet nga bashkia përmes **Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF)** dhe strukturave të tjera sociale në nivel vendor. Ky proces ndërmerret në faza të qarta dhe të strukturuar, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së fëmijës.

1. Identifikimi i rasteve

Rastet e fëmijëve që mund të jenë në rrezik identifikohen në mënyrë të shumëllojshme, përmes:

- Raportimeve nga shkollat, qendrat shëndetësore, policia, OJF-të dhe anëtarë të komunitetit;
- Sinjalizimeve direkte nga vetë fëmijët, familjarët apo qytetarët;
- Vëzhgimeve të stafit të shërbimeve sociale gjatë kontakteve me komunitetin;
- Sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve dhe platformave zyrtare të komunikimit (shkresor ose elektronik).

2. Vlerësimi fillestar dhe hapja e rastit

Pas marrjes së sinjalizimit, NJMF realizon një **vlerësim paraprak** të situatës nëpërmjet kontakteve me fëmijën, prindërit/kujdestarët dhe palë të tjera të përfshira. Nëse konstatohet se ekziston një rrezik real për fëmijën, rasti **hapet zyrtarisht dhe regjistrohet** si rast për ndjekje të mëtejshme.

3. Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes (PIM)

Për çdo rast të hapur, përgatitet një **Plan Individual i Mbrojtjes**, i cili:

- Përcakton nevojat specifike të fëmijës;
- Vendos objektivat e ndërhyrjes dhe tipin e mbështetjes së nevojshme;
- Identifikon institucionet dhe burimet përgjegjëse për zbatimin;
- Përfshin një kalendar veprimesh dhe përgjegjës të dedikuar.

4. Zbatimi dhe koordinimi i shërbimeve

Zbatimi i planit realizohet përmes një qasjeje të koordinuar, me përfshirjen e aktorëve institucionalë dhe jopublike, që sigurojnë:

- Mbështetje ekonomike dhe materiale;
- Këshillim psiko-social dhe mbrojtje ligjore;
- Ndërhyrje për rikthimin në arsim ose parandalimin e braktisjes;
- Akses në shërbime shëndetësore;
- Sigurim strehimi emergjent në rastet kur fëmija përballlet me dhunë ose rrezik të rëndë.

5. Monitorimi dhe ndjekja e rastit

Rastet monitorohen rregullisht nga NJMF për të siguruar që ndërhyrjet po japin efektin e pritshëm. Plani mund të **përshtatet ose përditësohet** në varësi të ndryshimeve të situatës së fëmijës.

6. Mbyllja e rastit

Një rast konsiderohet i mbyllur kur fëmija nuk paraqet më rrezik dhe është arritur stabiliteti emocional, fizik dhe social i tij/saj. Mbyllja dokumentohet në regjistrat zyrtarë dhe të dhënat përfshihen në **raportimin periodik të bashkisë**.

10.2 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje


Të dhënat nga njësitë administrative tregojnë një situatë shqetësuese sa i përket mbrojtjes së fëmijëve në rrezik dhe përkujdesjes institucionale për ta. Në total, shumica e njësive nuk raportojnë asnjë rast të menaxhuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara të trajtuar, apo përfshirje të strukturuar të fëmijëve që marrin ndihmë ekonomike ose që kërkojnë mbrojtje të veçantë.

1. Rastet e identifikuara dhe të menaxhuara nga NJMF

Gjatë vitit 2024, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në Bashkinë Mat kanë menaxhuar gjithsej 14 raste, të shpërndara në katër njësi administrative. Këto raste janë ndjekur sipas procedurave standarde të referimit dhe menaxhimit ndërinstitucional, në bashkëpunim me strukturat vendore të shërbimeve sociale, arsimit dhe policisë komunitare.

□ Shpërndarja e rasteve sipas njësive administrative:

- Burrel – 8 raste
- Rukaj – 3 raste
- Baz – 2 raste
- Ulëz – 1 rast



☐ Burrel mbetet zona me numrin më të lartë të rasteve të menaxhuara, çka lidhet me përqendrimin më të madh të popullsisë, por edhe me identifikimin më të mirë të rasteve falë pranisë më të fortë institucionale.

Numri i kufizuar i rasteve në njësitë e tjera mund të reflektojë një kombinim të faktorëve si nënraportimi, mungesë kapacitetesh për identifikim aktiv, ose mungesë ndërgjegjësimi në komunitet.

☐ Rekomandohet që në njësitë me raste të pakta të intensifikohen:

- fushatat informuese,
- rritja e kapaciteteve të stafit lokal, dhe
- mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional, për të garantuar mbrojtje të barabartë të fëmijëve në të gjithë territorin e bashkisë.

2. Fëmijët me aftësi të kufizuara

Asnjë njësi nuk ka evidentuar fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë **aftësi të kufizuara**, duke ngritur dyshime mbi kapacitetin e identifikimit dhe vlerësimit të diversitetit të nevojave.

3. Fëmijët përfitues nga familje me ndihmë ekonomike

Numri i fëmijëve që janë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe që janë identifikuar si në nevojë për mbrojtje mbetet gjithashtu i ulët:

- Rukaj (3 fëmijë)
- Burrel (5 fëmijë)
- Baz (2 fëmijë)

Në pjesën tjetër të njësive nuk raportohet asnjë rast, ndonëse varfëria mbetet një faktor i njohur rreziku për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.


4. Numri total i fëmijëve të identifikuar si në nevojë për mbrojtje/përkujdesje

Gjatë vitit 2024, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) në Bashkinë Mat kanë menaxhuar gjithsej **14 raste**, të shpërndara në katër njësi administrative. Këto raste janë ndjekur në përputhje me **procedurat standarde të referimit dhe ndërhyrjes ndërinstitucionale**, në bashkëpunim me strukturat vendore të **shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë dhe policisë komunitare**.

☐ Shpërndarja e rasteve sipas njësive administrative:

- **Burrel** – 8 raste
- **Rukaj** – 3 raste
- **Baz** – 2 raste
- **Ulëz** – 1 rast





□ **Burrel** mbetet zona me numrin më të lartë të rasteve të menaxhuara, gjë që lidhet jo vetëm me përqendrimin më të madh të popullsisë, por edhe me **funksionimin më të konsoliduar të strukturave mbështetëse dhe institucionale** për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve.

Nga ana tjetër, numri i kufizuar i rasteve në njësitë si **Ulëz**, **Baz** dhe **Rukaj** mund të pasqyrojë:

- nënraportimin e problematikave,
- mungesën e burimeve njerëzore të trajnuara,
- ose ndërgjegjësim të ulët në komunitet mbi rolin e NJMF.

□ **Rekomandime** për forcimin e ndërhyrjes në zonat me identifikim të ulët:

- Zhvillimi i **fushatave informuese dhe ndërgjegjëse**,
- **Fuqizimi i stafit vendor** përmes trajnimeve dhe mbështetjes teknike,
- **Ngritja e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional** në nivel lokal, për të garantuar **qasje të barabartë dhe të menjëhershme** në shërbime për çdo fëmijë në nevojë

10.3 Shërbimet për fëmijët në nevojë në Bashkinë Mat

Në territorin e bashkisë ofrohet aktualisht një qendër shërbimi social dedikuar fëmijëve, konkretisht **Qendra Ditore “Motrat Dorottea”**, e administruar nga Giuseppina Cappelletti dhe Nexhmie Koçi. Kjo qendër përfaqëson një nga nismat më të rëndësishme të mbështetjes së fëmijëve në nevojë, duke siguruar një sërë aktiviteteve dhe shërbimesh që synojnë zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Llojet e shërbimeve që ofrohen për fëmijët përfshijnë:

- Ushqim (drekë e përditshme)
- Mësim dhe mbështetje edukative
- Lojëra dhe aktivitete argëtuese

- Kurse kreative, përfshirë kursin e kitarës

Aktualisht, **30 fëmijë janë përfitues të drejtpërdrejtë** të këtyre shërbimeve.



Ky shërbim është thelbësor për:

- Parandalimin e braktisjes shkollore
- Mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve nga familje në nevojë
- Promovimin e barazisë së mundësive për fëmijët në situata të vështira ekonomike apo sociale

Roli i bashkisë në mbështetjen dhe mbikëqyrjen e kësaj qendre është i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjes sociale në fëmijëri të hershme dhe në moshë shkollore.

10.3 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja)

Aktualisht, në territorin e bashkisë funksionojnë **3 çerdhe publike**, të cilat ofrojnë kujdes dhe edukim për fëmijët e moshës 0–3 vjeç. Këto institucione përbëjnë një hallkë të rëndësishme të sistemit të kujdesit të hershëm, duke mbështetur njëkohësisht zhvillimin e hershëm të fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve, veçanërisht të grave në tregun e punës.

Kapaciteti total i licencuar i çerdheve është 93 fëmijë, ndërkohë që **numri aktual i fëmijëve të regjistruar është 106**, çka përbën një **tejkalim të kapacitetit prej rreth 14%**.


Ky tejkalim është tregues i një kërkesë në rritje për shërbimin në çerdhe, dhe njëkohësisht ngre shqetësime për:

- Cilësinë e shërbimeve të ofruara për shkak të mbingarkesës;
- Mungesën e stafit të mjaftueshëm apo të infrastrukturës mbështetëse për të garantuar standardet minimale për moshën 0–3 vjeç;
- Rrezikun e përjashtimit të fëmijëve në nevojë, për shkak të kapaciteteve të kufizuara.

10.4 Shërbimi i Arsimit Parashkollor

Në territorin e bashkisë janë në funksion 29 kopshte publike, të shpërndara në njësitë administrative dhe fshatrat përkatëse. Këto institucione ofrojnë shërbime të kujdesit dhe edukimit për fëmijët e moshës 3–6 vjeç, duke kontribuar në zhvillimin e tyre gjithëpërfshirës dhe përgatitjen për arsimin bazë.

- **29 kopshte funksionale** në të gjitha njësitë administrative,



Në vitin referues¹ në Bashkinë Mat janë identifikuar **595 fëmijë të moshës 3–6 vjeç**, nga të cilët **351 fëmijë** ndjekin kopshtin (185 djem dhe 166 vajza). Kjo përfaqëson një **shkallë përfshirjeje prej 58.99%**, duke reflektuar një boshllëk të ndjeshëm për përmirësim, veçanërisht për djemtë (56.40% përfshirje) në krahasim me vajzat (62.17%).

Gjithashtu, **244 fëmijë (143 djem dhe 101 vajza)** nuk janë të përfshirë aktualisht në institucione parashkollore, duke sinjalizuar nevojën për:


- rritje të ndërgjegjësimit të familjeve mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.
- ndërhyrje për përmirësimin e kapaciteteve dhe shërbimit të kopshteve,
- përmirësim të infrastrukturës apo riorganizim i shërbimit në zonat më të thella,

10.5 Shërbimi i arsimit parauniversitar

Në bashkinë Mat funksionojnë:

- **25 institucione arsimore** të niveleve të ndryshme (fillor, 9-vjeçar dhe i mesëm),
- një rrjet të përbërë nga **2 shkolla fillore, 10 shkolla 9-vjeçare dhe 6 shkolla të mesme** (gjimnaze dhe profesionale).

¹ Census 2023, viti shkollor 2023 – 2024



Kjo shpërndarje synon të garantojë **akses territorial** për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit, dhe përmbush objektivin strategjik për **zhvillim gjithëpërfshirës dhe të barabartë arsimor**.

Frekuentimi në Arsimin Fillor

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej **898 nxënës** (478 djem dhe 420 vajza), duke reflektuar një shpërndarje të barabartë dhe një pjesëmarrje të qëndrueshme. Përqindja e përfshirjes gjinore (53.23% djem dhe 46.77% vajza) tregon që shkollat fillore janë relativisht të aksesueshme dhe të përhapura afër vendbanimeve, duke mundësuar vijueshmëri të lartë në këtë fazë.

Frekuentimi në Arsimin 9-Vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar ndjekin shkollën **834 nxënës** (467 djem dhe 367 vajza), ku **djemtë përbëjnë 56%** të popullatës shkollore. Ndryshimet gjinore dhe përqindjet tregojnë variacione të lehta nga njësi në njësi, të ndikuara nga faktorë si distanca, migrimi, dhe situata ekonomike. Pavarësisht kësaj, shkollat 9-vjeçare mbeten struktura kyçe për garantimin e arsimit bazë dhe përgatitjen për fazën e mesme.

10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkollë

- **Bashkia Mat nuk ofron shërbim psiko-social në shkollë**, gjë që përfaqëson një boshllëk në ofrimin e mbështetjes emocionale dhe sociale për fëmijët në sistemin arsimor.
- **Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP)** ofron shërbim psiko-social, çka mbulon përkohësisht nevojat në këtë aspekt, por jo në mënyrë të integruar apo bashkiae.



10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Nuk ka masa lehtësuese të dedikuara nga Bashkia për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, çka tregon për mungesë ndërhyrjesh të strukturuar nga pushteti vendor për këtë kategori vulnerabël.

Rekomandohet fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP për të siguruar shërbime të integruara psiko-sociale, si dhe krijimi i një pakete masash mbështetëse nga vetë Bashkia për fëmijët në rrezik, si pjesë e një strategjie të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor.

11. Familjet rome dhe egjiptiane

Të dhënat mbi komunitetin rom dhe egjiptian në territorin e Bashkisë Mat janë të disponueshme vetëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Në nivel vendor, nuk disponohen statistika të detajuara apo të ndara sipas përkatësisë etnike, çka kufizon analizën e thelluar për këtë kategori dhe përbën një sfidë për planifikimin e ndërhyrjeve të synuara.

□ Rekomandohet të kërkohet akses i strukturuar në këto të dhëna përmes bashkëpunimit institucional, me qëllim garantimin e planifikimit gjithëpërfshirës dhe bazuar në evidencë për komunitetet rom dhe egjiptian.

12. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative

Në nivel njësie administrative, të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme të nevojave për shërbime sociale për të moshuarit në Bashkinë Mat:

- **Burrel** evidentohet si njësi me numrin më të lartë të rasteve, me 68 persona që përfitojnë shërbime (35 për ndihmë ekonomike, 30 në qendër ditore, 2 në strehim social dhe 1 në formë rezidenciale).
- **Baz, Koms** dhe **Rukaj** kanë gjithashtu një nivel të konsiderueshëm nevojash, kryesisht në ndihmë ekonomike dhe pjesërisht në shërbime ditore dhe strehim.
- **Derjan, Lis, Macukull** dhe veçanërisht **Ulëz**, paraqiten me numër më të ulët përfituesish, duke reflektuar qoftë mungesë kërkesash apo mundësi më të pakta shërbimi.

- **Bashkia Mat nuk disponon asnjë institucion rezidencial për të moshuarit në territorin e saj.**

Për rastet që kërkojnë kujdes të specializuar dhe akomodim afatgjatë, sistematik realizohet në institucione rezidenciale të ndodhura në qytete të tjera, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.



□ Kjo situatë nënvizon nevojën për:

- **Zhvillimin e shërbimeve alternative në komunitet**, si qendrat ditore për të moshuarit,
- **Forcimin e kapaciteteve vendore për identifikimin dhe referimin e rasteve**, dhe
- **Koordinim të vazhdueshëm me strukturat rajonale**, për të garantuar një trajtim dinjitoz për të moshuarit që nuk mund të jetojnë të pavarur ose pa mbështetje familjare.

12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit

Bashkia Mat ofron aktualisht dy lloje shërbimesh sociale për të moshuarit në nevojë:

- **Shërbim në qendër ditore** – i cili synon të ofrojë një ambient socializimi dhe përkujdesjeje të përditshme për të moshuarit.
- **Mbështetje me paketa ushqimore** – që kontribuon në përmbushjen e nevojave themelore ushqimore për individët e moshuar në kushte vulnerabiliteti.

Këto shërbime janë të një rëndësie të veçantë për sigurimin e mbështetjes bazike për të moshuarit në nevojë, por kërkohet rritje e gamës dhe mbulimit të tyre për të qenë më gjithëpërfshirës.

13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli

Në Bashkinë Mat, për periudhën e raportuar nuk është identifikuar asnjë rast i personave me varësi nga droga apo alkooli. Kjo mungesë e rasteve të raportuara mund të jetë pasojë e disa faktorëve: mungesa e instrumenteve të monitorimit aktiv, stigma sociale që lidhet me pranimin e varësisë, apo mosfunksionimi i mekanizmave efektivë të referimit.

Identifikimi i rasteve, sipas informacionit të dhënë, bëhet kryesisht nga ana e policisë përmes patrullimeve, kontrolleve në territor dhe ndërveprimeve me komunitetin. Kjo tregon se nuk ka një mekanizëm të strukturuar dhe proaktiv në nivel lokal për identifikimin e hershëm të rasteve të varësisë.

Po ashtu, Bashkia Mat nuk ofron aktualisht shërbime të kujdesit shoqëror për personat me varësi, çka tregon për një boshllëk të rëndësishëm në gamën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore që duhet të jenë në dispozicion të kësaj kategorie vulnerabël.

14. Migrantët dhe Emigrantët

Në Bashkinë Mat, nuk disponohen të dhëna zyrtare për numrin e migrantëve të brendshëm dhe emigrantëve (persona që kanë emigruar jashtë vendit). Kjo mungesë informacioni përbën një sfidë të rëndësishme për planifikimin social dhe për hartimin e politikave që synojnë mirëqenien e familjeve të prekura nga migrimi.



15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Mat

Bashkia Mat ka funksionale:

Shërbimi	Forma minimale	Burimi Ligjor	Po/Jo/Pjesërisht
Zyrë shërbimesh sociale	1 PS + 1 Psikolog	Ligji 121/2016	Jo
Menaxhim rastesh për fëmijë	Mekanizëm referimi	Ligji 18/2017	Po
Shërbim për PAK	Qendër ditore ose home-care	VKM 1074/2015	Pjesërisht
Mbështetje për të moshuar	Vizita shtëpie ose klub social	VKM 821/2006	Pjesërisht
Ndihmë për viktimat e dhunës	Strehë, referim, psikolog	Ligji 9669/2006	Pjesërisht
Rrjet referimi vendor	Strukturë ndërsektoriale	Udhëzim nr. 10/2018	Po

Bashkia	Shërbimet funksionale në Bashki	Shërbimet e nevojshme për tu ngritur në bashki
Mat	○ shërbimet parashoqërore;	○ shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit; ○ shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat; ○ shërbimet shoqërore në situatë emergjence; ○ shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

Fusha e Shërbimit	Aktualisht ekziston? (Po/Jo)	Planifikohet të zhvillohet	Nevojat për mbështetje (burime njerëzore, financiare, teknike)qeveria qendrore/OJF.



Zyrë e shërbimit social me staf të kualifikuar	Po		Nevojë për mbështetje burime njerëzore, financiare, teknike
Menaxhim i rasteve të fëmijëve në risk	Po		
Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)	Po		
Shërbime për të moshuarit		Po	Nevojë për mbështetje burime njerëzore, financiare, teknike
Shërbime për viktimat e dhunës në familje		Po	Nevojë për mbështetje burime njerëzore, financiare, teknike
Qendra komunitare për grupe vulnerabël		Po	
Strehim emergjent për persona në nevojë		Po	
Shërbime për përdorues të substancave ose me çrregullime mendore	Jo		
Sistem dokumentimi dhe ndjekje e rasteve	Po		
Rrjet referimi ndërsektorial vendor	Po		

16. Kapacitetet e bashkisë

Sipas të dhënave të raportuara, **në asnjë nga Njësitë Administrative të Bashkisë Mat nuk ka të punësuar punonjës të mbrojtjes së fëmijëve (PMF)**. Kjo përfshin të gjitha njësitë: Baz, Burrel, Derjan, Rukaj, Macukull, Koms, Lis dhe Ulëz.

Kjo situatë ka pasoja të rëndësishme për:

- **Zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve**, ku roli i PMF-ve është kyç për identifikimin, ndjekjen dhe mbështetjen e rasteve në rrezik;
- **Parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe ndërhyrjen në kohë**, përmes vlerësimeve në terren dhe Planit Individual të Mbrojtjes (PIM);
- **Koordinimin me institucionet vendore dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse**, duke qenë se PMF-të janë pika lidhëse në Mekanizmin Vendor të Mbrojtjes së Fëmijëve.



Të dhënat tregojnë se në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Mat ka të paktën një administrator shoqëror, përveç njësisë së **Burrelit**, e cila ka një numër më të lartë **3 administratorë**. Kjo është një shenjë pozitive për **shtrirjen e shërbimeve sociale në territor** duke siguruar prani të strukturave bazë për identifikimin dhe mbështetjen e grupeve në nevojë.

Megjithatë, për një territor të gjerë dhe me popullsi të shpërndarë si Mat, **prania e vetëm një administratori në shumicën e njësive** mund të rezultojë e pamjaftueshme për:

- trajtimin në kohë të kërkesave dhe rasteve urgjente;
- mbulimin efektiv të fshatrave të largëta;
- ndjekjen e rasteve që kërkojnë ndërhyrje të përsëritura (fëmijë, PAK, të moshuar, etj.).

Bashkia **ka ngritur Njësinë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave**, një hap pozitiv që ndihmon në koordinimin ndërsektorial për rastet komplekse.

Juristë: 3 juristë në strukturën e bashkisë.

Në territorin e Bashkisë Mat funksionon Spitali Bashkiak në qytetin e Burrelit, i cili ofron mbështetje mjekësore për rastet që paraqesin nevoja shëndetësore të identifikuara nga strukturat sociale.

Shërbimet sociale që ofrohen nga bashkia:

- ☐ **Shërbime parashoqërore** (mbështetje bazë sociale për kategori në nevojë)
- ☐ **Shërbime shoqërore në situata emergjente** (p.sh. për viktime të dhunës, strehim emergjent)
- ☐ **Mungesë** e shërbimeve në qendrat komunitare ose rezidenciale
- ☐ **Mungesë** e shërbimeve të kujdesit alternativ për fëmijë pa përkujdesje prindërore
- ☐ **Mungesë** e shërbimeve të specializuara ose të këshillimit online



17. Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Të garantohet akses i barabartë dhe cilësor në shërbimet sociale për të gjithë qytetarët në nevojë në territorin e Bashkisë Mat, në përputhje me karakteristikat dhe prioritetet lokale.

Misioni

Përmes zbatimit të këtij Plani Social, Bashkia Mat angazhohet të ofrojë shërbime sociale gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për grupet më vulnerabël, duke bashkëpunuar me aktorë vendorë dhe partnerë të sektorit publik dhe jopublik, për të garantuar përfshirje, mbrojtje dhe dinjitet për çdo qytetar në nevojë.

18. Qëllimet dhe Objektivat

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

- **Objektivi 1.1:** Përmirësimi i riintegrit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.

- **Objektivi 1.2:** Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve financiare në situata krizash dhe emergjencash.
- **Objektivi 1.3:** Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.
- **Objektivi 1.4:** Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

- **Objektivi 2.1:** Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.
- **Objektivi 2.2:** Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.
- **Objektivi 2.3:** Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës
- **Objektivi 2.4:** Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.

19. Plani i Veprimit

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<i>Objektivi 1.1: Përmirësimi i riintegritetit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.</i>						
A1.1.1 Nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e të rinjve (vajza dhe djem, nga zonat rurale dhe urbane) nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike për arsim, formim, këshillim dhe punësim, përmes identifikimit dhe referimit të tyre. (lidhja me garancinë rinore);	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i të rinjve (vajza dhe djem) përfitues të ndihmës ekonomike që janë identifikuar dhe referuar nga bashkia drejt shërbimeve të arsimit, formimit profesional, këshillimit apo punësimit.	Bashkia, parteritet me AKPA dhe SHSSH	2,000,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale



A1.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi nga bashkia i formave të mbështetjes për punësim dhe vetëpunësim të përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë pune, veçanërisht në zonat rurale, me qëllim daljen graduale nga skema; me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat, prindërit e vetëm dhe nënat kryefamiljare, për të reduktuar barrën e punës së papaguar dhe të kujdesit.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2027 2028	Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë pune që janë referuar drejt masave për punësim, formim ose vetëpunësim. (gra/burra) Numri i grave dhe vajzave përfituese të NE që janë përfshirë në skema punësimi ose vetëpunësimi. Numri i nënave kryefamiljare dhe prindërve të vetëm që kanë dalë nga skema si rezultat i përfshirjes në punësim ose ndërmarrje të vogla.	Bashkia, parteritet me AKPA dhe SHSSH	5,000,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
---	--	----------------------	--	--	------------------	---------------------------------------



			Numri i masave mbështetëse të ndërmarrë nga bashkia (trajtime, grante të vogla, partneritete me OJF/OSHC) për punësim të përfituesve të NE.			
A1.1.3. Organizimi i fushatave lokale të ndërgjegjësimit, në bashkëpunim me Zyrat e Punës dhe partnerë të tjerë, për të informuar komunitetin – veçanërisht grupet në nevojë (gra, të rinj, PAK, prindër të vetëm) – mbi mundësitë e punësimit, formimit profesional dhe afatet e mbështetjes.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe/ose partnerë të tjerë lokalë. Numri i pjesëmarrësve në fushata, të ndarë sipas gjinisë dhe grupeve të targetuara (gra/vajza, të rinj, PAK, prindër të vetëm).	Bashkia, parteritet me AKPA dhe SHSSH	5,000,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale



			Numri i referimeve të bëra pas fushatave drejt shërbimeve të punësimit ose formimit profesional. Përqindja e fushatave të realizuara në zonat rurale nga total fushatave. Numri i materialeve informuese të shpërndara (fletëpalosje, posterë, njoftime dixhitale).				
A1.1.4 : Rritja e kapaciteteve të personelit të sektorit të shërbimeve sociale në nivel vendor	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Partneritet me organizata joqeveritare	2026 2027 2028	Numri i aktiviteteve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të realizuara për stafin e shërbimeve sociale të bashkisë.	Bashkia, Donatorë	OJF,	900,000	Zv.Kryetari

			Numri i punonjësve të përfshirë në trajnim (administratorë, punonjës NJVRN, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, etj.). Përqindja e stafit të sektorit të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në të paktën një aktivitet formimi gjatë vitit. Numri i moduleve tematike të trajtuara (vlerësim i nevojave, ndjeshmëri gjinore, menaxhim rastesh, etj.).			
--	--	--	--	--	--	--



			Përqindja e pjesëmarrësve që raportojnë përmirësim të njohurive pas përfundimit të trajnimit.			
A1.1.5. Rishikimi periodik i Planit Social	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit	2026 2027 2028	Numri i rishikimeve zyrtare të Planit Social të realizuara gjatë periudhës 3-vjeçare. Numri i raporteve të monitorimit dhe zbatimit të Planit Social të përgatitura nga bashkia. Përqindja e masave të Planit Social të vlerësuara nëpërmjet monitorimit dhe rishikimit.	Bashkia	0	Zv.Kryetari



			Numri i konsultimeve të organizuara me aktorë lokalë dhe komunitetin për rishikimin e Planit. Numri i masave të përmirësuara, shtuar ose përshtatur në Plan pas rishikimit.			
<i>Objektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve financiare në situata krizash dhe emergjencash.</i>						



A1.2.1 Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Njësi Administrative Koms, Lis <i>Rishikim i përshkrimit të punës dhe strukutra:</i> • <i>Punonjës social-1 shtesë</i>	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2027 2028	NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;	Bashkia	1,980,000	Zv.Kryetari
A1.2.2 Ndarja e pozicionit të punës të kordinatorit të dhunës në familje dhe specialistit të barazisë gjinore.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Kryetari i Bashkisë	2026 2027	Përshkrim i qartë pune për rolin dhe detyrat e kordinatorit të dhunës dhe specialistit të barazisë gjinore	Bashkia	0	Drejtoria e Shërbimeve Sociale



A1.2.3. Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin e rasteve emergjente sociale, përmes trajnimeve të dedikuara dhe krijimit të një databaze vendore për personelin e trajnuar.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Sektori i Emergjencave Civile	2027 2028	Numri i trajnimeve të organizuara për personelin e bashkisë mbi menaxhimin e rasteve emergjente sociale. Numri i punonjësve të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në trajnimet për emergjencat. Përqindja e stafit të sektorit të shërbimeve sociale të trajnuar për reagimin në situata emergjente. Ekzistenca e një databaze funksionale dhe të përditësuar të personelit të trajnuar për raste emergjente.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, SHSSH	800,000	Zv.Kryetari
--	--	----------------------	---	--	----------------	--------------------



			Numri i përditësimeve të databazës së personelit të trajnuar të realizuara nga bashkia gjatë periudhës së Planit.			
--	--	--	---	--	--	--

Objektivi 1.3: Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.

A1.3.1. Rritja e kapaciteteve të strukturave vendore për zbatimin e reformës së vlerësimit biopsiko-social të personave me aftësi të kufizuara, përmes forcimit të burimeve njerëzore, trajnimeve për miradministrim dhe ndërtimit të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit në nivel vendor.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, SHSSH	2027 2028	Numri i punonjësve të përfshirë në strukturat e vlerësimit biopsiko-social që janë trajnuar nga bashkia. Ekzistenca e një strukture funksionale të vlerësimit biopsiko-social në bashki.	Bashkia, parteritet me SHSSH, donatorë	0	Zv. Kryetari
--	---------------------------------------	--------------	---	--	---	--------------



			Numri i vlerësimeve biopsiko-sociale të kryera nga strukturat e bashkisë gjatë vitit. Numri i mekanizmave të monitorimit të procesit të vlerësimit të ngritur në bashki (formularë, raporte, takime koordinimi). Përqindja e rasteve të vlerësuara që janë ndjekur me plan shërbimi dhe referim të mëtejshëm.			
--	--	--	--	--	--	--



A1.3.2. Zgjerimi dhe përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në nivel vendor, përmes ofrimit dhe lehtësimit të aksesit në shërbime shoqërore, shëndetësore, arsimore, si dhe programe të formimit të aftësive për jetesë të pavarur dhe punësim.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	2027 2028	Numri i PAK-ve që kanë përfituar shërbime të mbështetjes përmes strukturave të bashkisë (sociale, shëndetësore, arsimore, formim/punësim). Numri i llojeve të shërbimeve mbështetëse të ofruara për PAK në territorin e bashkisë. Përqindja e PAK-ve të identifikuar nga bashkia që janë lidhur me të paktën një shërbim mbështetës.	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	2,000,000	Zv. Kryetari
---	---	----------------------	---	--	------------------	---------------------



			Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike ose OJF për ofrimin e shërbimeve për PAK. Numri i rasteve të PAK-ve që kanë përfituar mbështetje për përfshirje në arsim ose formim profesional.			
A1.3.3. Forcimi i Mekanizmit Vendor të Referimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), përmes menaxhimit të integruar të rasteve nga ekipe multidisiplinare, krijimit të profileve individuale të PAK, dhe zbatimit të protokolleve për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përballen me dhunë gjinore.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i rasteve të PAK-ve të trajtuara nga Mekanizmi Vendor i Referimit përmes menaxhimit të integruar të rastit. Numri i profileve individuale të PAK-ve të krijuara dhe të pasuruara nga ekipet multidisiplinare.	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	990,000	Zv. Kryetari



			Numri i protokolleve të miratuara dhe të zbatuara për rastet e PAK, përfshirë mbrojtjen nga dhuna. Numri i rasteve të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të identifikuar si viktima të dhunës që kanë përfituar ndërhyrje të koordinuara për mbrojtje dhe mbështetje. Numri i takimeve funksionale të Mekanizmit të Referimit për menaxhimin e rasteve të PAK.			
--	--	--	---	--	--	--

Objektivi 1.4: Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.



A 1.4.1: Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes në shtëpi për të moshuarit e vetmuar dhe në pamundësi fizike	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, partneritet me OJF apo qendra shëndetësore.	2027 2028	Numri i të moshuarve përfitues / numri i vizitave mujore / % e rasteve të ndjekura rregullisht.	Bashkia	10,000,000	Zv. Kryetari
A 1.4.2: Fushata ndërgjegjësimi për mbështetjen e të moshuarve nga komuniteti dhe familja, nëpërmjet shkollave, qendrave komunitare, rrjeteve të të rinjve, etj. Fokus: edukimi ndërbreznor dhe rritja e ndjeshmërisë sociale.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri i fushatave / materialeve informuese / pjesëmarrësve të angazhuar.	Bashkia	200,000	Zv. Kryetari



QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJË S	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 2.1 Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.						
A.2.1.1. Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, i shoqëruar me materiale informuese dhe edukuese, për të adresuar normat dhe sjelljet negative që lidhen me dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve, duke përfshirë edhe çështjen e martesave të hershme.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, partnerë	2026 2027	Plani i komunikimit i përgatitur dhe miratuar nga bashkia. Numri i produkteve me mesazhe sensibilizuese të përgatitura dhe shpërndara. Numri i personave të informuar ose të përfshirë në aktivitetet e ndërgjegjësimit.	Bashkia Donatorë	400,000	Zv.Kryetari



A.2.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve mbi prindërimin pozitiv, të përshtatura për përdorim nga profesionistët vendorë, përfshirë punonjësit e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve , si dhe profesionistët e qendrave komunitare. Trajnimet synojnë fuqizimin e aftësive për mbështetjen e prindërve në funksion të mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027	Numri i prindërve të këshilluar mbi prindërimin pozitiv, përfshirë ata me aftësi të kufizuar	Bashkia	300,000	Zv.Kryetari
A.2.1.3 Zhvillimi i ndërhyrjeve për ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor dhe mbështetjen e krijimit të një kulture gjithëpërfshirëse dhe pozitive, që refuzon dhunën, bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aktorët lokalë.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri dhe % e shkollave ku kanë zbatuar plane të veprimtarive ndërgjegjëse	Bashkia	300,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Objektivi 2.2: Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.



A.2.2.1 Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara për menaxhimin e rasteve me qasje ndërsektoriale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Partnerë,	2026 2027 2028	% e punonjësve të trajnuar çdo vit; Tematikat e trajnimit	Bashkia Donatorë	900,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
A.2.2.2 Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe referimi tek shërbimet	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës	2026 2027 2028	Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve të fëmijëve për të cilët janë marrë masa mbrojtëse; Numri i rasteve të fëmijëve të mbështetur me shërbime; Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takime;	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	300,000	Kabineti i Kryetarit Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Aktiviteti 2.2.3 Shërbimi i këshillimit me telefon.	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit;	Bashkia në partneritet me Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111	0	Kabineti i Kryetarit
--	--------------------------------	----------------------	---	--	---	----------------------

Objektivi 2.3: Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës

A.2.3.1 Funksionimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Marrëveshja e nënshkruar mes Kryetarit të Bashkisë dhe drejtuesve të institucioneve të parashikuara në legjislacionin specifik; Numri i takimeve të Komitetit Drejtues dhe çështjet e diskutuara; Raporte dhe analiza të përgatitura për Komitetin Drejtues; Masa të marra në vijim të takimeve të Komitetit Drejtues;	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në legjislacionin specifik, si dhe organizatat joqeveritare pjesë e Komitetit.	300,000	Kabineti i Kryetarit
--	--------------------------------	----------------------	---	--	---------	----------------------



			Rritje e ndërgjegjësimit komunitar kundër dhunës; Reduktim i dhunës në familje;			
A.2.3.2 Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi tek shërbimet	Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje në partneritet me administratorët shoqëror	2026 2027 2028	Numri i rasteve të dhunës të referuara; Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes multisektoriale; Numri i viktimave të dhunës të pajisura me Urdhër mbrojtje/ Urdhër të menjëhershëm mbrojtje; Numri i viktimave të dhunës që kanë marrë shërbime reabilituese/fuqizuese;	Bashkia	300,000	Drejtoria e Shërbimeve Sociale
A.2.3.3 Shërbimi i këshillimit me telefon	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2026 2027 2028	Numri i rasteve të viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe marrë këshillim;	Bashkia	0	Kabineti i Kryetarit



			Numri i rasteve të vitkimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje;			
A.2.3.4 Shërbim emergjence 72 orë dhe strehim i mbrojtur për viktimat e dhunës në familje	Drejtoria e Shërbimeve Sociale Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje	2026 2027 2028	Apartamentet funktionale për çdo rast; Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim; Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës; Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime rehabilituese dhe riintegruese;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	3,420,000	Zv.Kryetari

Objektivi 2.4: Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.



A.2.4.1 Zbatimi i një procesi periodik monitorimi nga bashkia për të vlerësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve komunitare sociale që ofrohen në territorin e saj, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e përfituesve.	Punonjësi social/	2026	Numri i monitorimeve të realizuara mbi shërbimet komunitare nga bashkia.	Bashkia	0	Zv.Kryetari
	Drejtoria e	2027				
	Shërbimeve Sociale	2028				
	Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror		Numri i shërbimeve komunitare të vlerësuara për cilësinë dhe përshtatshmërinë.			
			Përqindja e shërbimeve që përmbushin standardet minimale të cilësisë sipas vlerësimit të bashkisë.			
			Numri i rekomandimeve të dalë nga procesi i monitorimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.			



			Përqindja e rekomandimeve të zbatuara brenda vitit nga ofruesit e shërbimeve. Numri i takimeve të organizuara me përfitues ose staf për të mbledhur feedback mbi shërbimet.			
A.2.4.2 Ngritja e një qendre komunitare për grupet vulnerabël: <i>Këshillim psikologjik;</i> <i>Qendër ditore për fëmijë dhe të rinj</i> <i>me aftësi të kufizuara</i> <i>Qendër ditore për fëmijët dhe</i> <i>mbështetje për arsimin e fëmijëve</i> <i>gjatë orëve të pasdites;</i> <i>Aktivitete</i> <i>argëtuese për fëmijët;</i> <i>Këshillim psikologjik;</i> <i>Qendër ditore për të moshuarit;</i> <i>Shërbim i kujdesit për fëmijët e</i>	Drejtoria e Shërbimeve Sociale	2027 2028	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare; Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	52,336,000	Zv.Kryetari



nënave kryefamiljare, viktima të dhunës në familje apo trafikimit Shërbim i asistencës në familje për Pak dhe të moshuar Shërbime emergjence Shërbim lëvizës			Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra sipas targ			
--	--	--	--	--	--	--





20. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Planin Social 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

Njësia e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve:

- **Drejtoria e Shërbimeve Sociale**, do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave, do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

Treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror:

- Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, numri i strukturave të ngritura, ngjirja dhe funksionalizimi i shërbimeve të reja, etj. Treguesit aty ku është e mundur paraqiten të ndarë sipas gjinisë, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale). **Treguesit paraqiten të detajuar në planin e veprimit, për secilin aktivitet.**

Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së realizimit të planit social, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi



Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.



21. Bibliografi

- Asambleja e Kombeve të Bashkuara. (1948). *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- Kuvendi i Shqipërisë. (2016). *Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”*. Fletorja Zyrtare nr. 193, datë 14.11.2016.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2014). *Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*. Fletorja Zyrtare nr. 215, datë 17.12.2015.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020). *Standardet minimale për shërbimet sociale në komunitet për persona në nevojë*. Tiranë.
- Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 505, datë 13.09.2018 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve sociale”*. Fletorja Zyrtare.
- Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 118, datë 13.3.2018 “Për procedurat e licencimit dhe akreditimit të ofruesve të shërbimeve sociale”*. Fletorja Zyrtare.
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. (2022). *Manuali për monitorimin e standardeve të shërbimeve për fëmijë*. Tiranë.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Udhëzues për menaxhimin e rasteve në shërbimet sociale komunitare*. Tiranë.
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). (2022). *Raporti për kapacitetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale*. Tiranë.
- Save the Children Albania & UNICEF Albania. (2021). *Manual praktik për bashkitë për zhvillimin e shërbimeve sociale*. Tiranë.

Lista e legjislacionit të marrë në analizë

Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; (në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55);

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;
- Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Ligji nr. 108, datë 2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB -së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe Protokolli nr. 7 i KEDNj;



- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr.182 “Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligj nr. 9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”;
- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”;
- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
- **Ligji nr. 121, datë 24.11.2016, ”Mbi Shërbimet e Kujdeist Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;**
- Ligji nr. 163/2014 “Për urdhërin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë “;
- Ligji nr. 40/2016, i ndryshuar “Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”;
- **Ligji 18/2017 ”Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;**
- **Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;**
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar ;
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**
- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Karta Evropiane për Autonomi Lokale;
- VKM nr 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 10.2.2021;nr. 868, datë 29.12.2021; nr. 617, datë 22.9.2022);
- VKM nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” i ndryshuar;
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës



personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” i ndryshuar;

- VKM nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;

- VKM nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar;

- VKM nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “statusi i invalidit”, i ndryshuar;

- VKM nr.277 date 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”;

- Vendim nr. 257, datë 5.5.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”;

- Vendim nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, i ndryshuar;

- Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”;

- Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 “Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”;

- Vendim nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”;

- Vendim nr. 174, datë 24.3.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025”;

- VKM Nr. 768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të vecanta”;

- VKM 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;

- **VKM Nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;**

- VKM 136/2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;

- VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”;

- VKM Nr. 848, datë 28.10.2020 “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”;

• VKM Nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;

• VKM nr. 111 datë 23 shkurt 2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social;

• VKM Nr. 150 datë 20/03/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

